



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 67 Prot

Datë, 20.04.2020

VENDIM

Nr.11, datë 20.04.2020

PËR

**SHTYRJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR REKTOR DHE ANËTAR
TË SENATIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në zbatim të nenit 18 të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë; Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor Nr. 1, datë 11.03.2020 "Për kryerjen e detyrave funksionale të Komisionit Institucional Zgjedhor përmes komunikimit telefonik dhe elektronik", si dhe Urdhërit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 99, datë 26.03.2020 "Për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 8, datë 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtyrjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve datën 27.04.2020, deri në datën 01.05.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Institucional Zgjedhor për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidati pajiset me vërtetimin e regjistrimit si kandidat nga Komisioni Institucional Zgjedhor.
4. Kandidatët për Senatin Akademik, përfaqësues të studentëve, paraqiten personalisht në zyrën e Komisionit Institucional Zgjedhor, ndërsa deklaratat e jo më pak se 30 (tridhjetë) propozuesve të tyre, të cilët mbështesin vetëm një kandidat, ku pasqyrohet emri, mbiemri, mjeti i identifikimit dhe fakulteti / dega ku studion studentin, depozitohen elektronikisht në adresën zyrtare kiz@univlora.edu.al.
5. Vendimi afishohet në të gjitha mjediset e universitetit, si dhe publikohet në faqen web www.univlora.edu.al.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Komisionit Institucional Zgjedhor
Oljana Hoxhaj**

**Anëtarët
Shkëlqim Sinanaj
Eljona Zanaj
Evis Allushi
Kristi Mucollari**